

Ndihmë sociale me financa

### **Ndihma sociale e qytetit St. Gallen**

Kush gjindet përkohësisht ose vazhdimisht në një ngushticë financiare dhe me gjithë mundimet e veta nuk mund të dalë prej kësaj ose nuk mund të dalë brenda afateve, ka një të drejtë për ndihmë financiare, përderisa vendbanimi ndodhet në qytetin St.Gallen. Pagesat e ndihmës sociale llogariten individualisht, shuma varet nga rrethanat personale, nga kostot e jetesës dhe nga gjendja e të ardhurave.

#### **Regjistrim i ri / Sqarim pretendimi**

Për një regjistrim të ri ose një informacion të përgjithshëm për sqarimin e një pretendimi për pagesa të ndihmës sociale ju duhet të paraqiteni **personalisht** tek Shërbimet Sociale në këto orare (pa pajtim termini): Të hënën deri të enjten nga ora 13:30 - 16:30. Për regjistrimin e ri duhet një kartë e vlefshme identiteti.

Vazhdimi i procedurës prezantohet në një bisedë të shkurtër personale. Biseda zhvillohet në gjermanisht.